



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:088056
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05430105

P.nr.1943/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Sabit Sadikaj, duke vendosur, në çështjen penale ne rigjykim ndaj të akuzuarve, A.B, si dhe M.K për shkak se: te pandehurit A.B dhe F.M në bashkëkryerje kane kryer veprën penale “Shantazhi”, nga neni 268 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, i pandehuri F.M ka kryer veprën penale “Mbajtja ne pronësi, ne kontroll, ne posedim ose ne shfrytëzim te pa autorizuar te armeve” nga neni 328 par. 2 te KPPK-se, i pandehuri A.B a kryer veprat penale “Mbajtja ne pronësi, ne kontroll, ne posedim ose ne shfrytëzim te pa autorizuar te armeve” nga neni 328 par. 2 te KPPK-se dhe “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve te rrezikshëm dhe substancave psiko-trope” nga neni 229 par. 4 pika 1 te KPPK-se ndërsa i pandehuri M.K, ka kryer veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” nga neni 332 par. 3 te KPPK-se te akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.485/04 të datës 02.08.2004, mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë: 31.01.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Besnik Jakupi, mbrojtësit të te pandehurit A.B, Av. Haxhi Dërguti, si dhe të pandehurit, mbrojtësit të te pandehurit F.M, Av. Alban Makolli, si dhe të pandehurit, kurse me datë 02.02.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 03.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Te akuzuarve:

- I. A.B, nga babai R dhe nëna M, e gjinisë S, i lindur me “data e lindjes”, me vendbanim ne Ulpianë rr. “emri i rrugës” H.. nr....., i pa punësuar, me nr. personal “letërnjoftim”, shkollën e mesme te kryer, Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës.
- II. F.M i biri i M dhe H, e gjinisë C, i lindur me date “data e lindjes”, me vendbanim ne rrugën “emri i rrugës” p.n. ne Prishtine, i vetëpunësuar, me nr. personal “letërnjoftim”, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

Të akuzuarit, A.B dhe F.M me të dhënat si me lart,

Konform nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPPK-së,

LIROHEN NGA AKUZA

S e p s e:

Me datën 01.07.2004 rreth orës 11:30 minuta në Prishtinë të pandehurit A.B dhe F.M kanë shkuar në banesën e të dëmtuarit B.K, lagja Bregu i diellit në Prishtinë, pasi e kanë ftuar me dal me pi kafe, gjatë rrugës kanë marrë një person me emrin A pastaj shkojnë në kompleksin e banesave të personelit të aeroportit dhe hyjnë në banesën hyrja-- nr. -- rruga "Fehmi Agani" në Prishtinë, dhe posa hyri i dëmtuari B.K në banesë, u ulën, i ofrojnë një pije, në ndërkohë F.M i tha A.B se unë po dal jashtë ndërsa do të kthehem më vonë pastaj e ka ftuar A deri te dera, ndërsa i dëmtuari ka mbetur brenda me personin e quajtur A, pastaj A u kthye dhe i tha të dëmtuarit B.K "puna është keq". I dëmtuari pyet se çka ka të re, A.B i tha se F.M po lyp haraq prej teje, ku në fillim A.B ka kërkuar 16.000 euro pastaj ka ra në 14.000, ndërsa pas një ore ka ra në 10.000 euro, ku A.B ia tërhoqi vërejtjen të dëmtuarit se në një farë mënyrë ne jemi të rrethuar nga F me shokë dhe i tha se nëse tenton diçka F,M është prapa teje në kuzhinë dhe do të shkon kryet, dhe i njëjti i thotë se F është me revole në dorë, këtu ka qenë prezent edhe personi i quajtur A, i cili e ka marrë pushkën automatike A-47 dhe e ka vendosur në karrige, pastaj kanë urdhëruar të dëmtuarin B.K që të marr telefonin e tij mobil dhe të thërras babain e tij dhe ti thotë se ka borxh një shumë prej 14.000 dhe se duhet t'i sjell ato para ose do të vritet. I dëmtuari B.K fton motrën e tij S.K dhe arrijnë një marrëveshje që të sjell shumën prej 1.000 eurosh , duke u takuar me të pandehurin A.B te restorant "D---". Pastaj të dëmtuarin B.K e marrin me vete dhe shkojnë te restoranti "D-----" ku motra e të dëmtuarit S.K u sjell 1.000 euro dhe të dëmtuarin B.K e lirojnë duke e kërcënuar se nëse paraqet rastin në polici atë do ta vrasin, ku me datën 05.07.2004 gjatë bastisjes së shtëpinë së të pandehurit F.M kanë gjetur 2 karikator të cilët i mbante pa autorizim,

- me këtë në bashkëveprim kishin për të kryer veprën penale “Shantazhi” nga neni 268 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPPK-së lidhur me nenin 23 të KPPK-së.
- Pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.
- Pala e dëmtuar B.K me vendbanim në Lagjen “lagje” rr. ---hyrja.--- nr.--- në Prishtinë, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

II

Po ashtu gjykata për të akuzuarin, A.B në bazë të nenit 362 par.1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-së, ka vendosur qe të:

REFUZOHET AKUZA

Sepse:

Me datën 05.07.2004 rreth orës 04:00 në banesën nr. -- hyrja --- rruga "Fehmi Agani" në Prishtinë në të cilën banesë e kishte marrë me qira para 3 muajve nga pronari J.K dhe atë në shumën prej 270 eurosh pas bastisjes nga ana e pjesëtareve të SHPK në këtë banesë pa autorizim ka poseduar me qëllim shitje, shpërndarjeje, substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme dhe substanca psiko-tropike ku gjatë bastisjes në këtë banesë, është gjetur një sasi heroinë, prej 3,920 kg , një peshore, letra folje dhe dy pako te qeseve plastike për paketim të cilat i pandehuri A.B ka marr pjesë si anëtar i një grupi

-me këtë kishte për të kryer veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psiko-tropike” nga neni 229 par. 1 të KPPK-së.

- Pasi që për këtë veprë penale, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.
- Pala e dëmtuar B.K me vendbanim në Lagjen “rruga” rr... hyrja... në Prishtinë, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.
- Shpenzimet procedurale dhe paushalli gjyqësorë bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Arsyetim

Rrjedha e procedurës, Historiku:

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.485/04 të datës 02.08.2004, ndaj të akuzuarve, A.B, F.M dhe M.K për shkak se: te pandehurit A.B dhe F.M në bashkëkryerje kane kryer veprën penale “Shantazhi”, nga neni 268 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, i pandehuri F.M ka kryer veprën penale “Mbajtja ne pronësi, ne kontroll, ne posedim ose ne shfrytëzim te pa autorizuar te armeve” nga neni 328 par. 2 te KPPK-se, i pandehuri A.B a kryer veprat penale “Mbajtja ne pronësi, ne kontroll, ne posedim ose ne shfrytëzim te pa autorizuar te armeve” nga neni 328 par. 2 te KPPK-se dhe “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve te rrezikshëm dhe substancave psiko-trope” nga neni 229 par. 4 pika 1 te KPPK-se ndërsa i pandehuri M.K ka kryer veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” nga neni 332 par. 3 te KPPK-se. Gjykata e Qarkut Prishtine gjate vitit 2004 mbajti shqyrtimet gjyqësore ndaj çështjes dhe me date 17.12.2004, shpalli Aktgjykimin ndaj te pandehurve ne bazën e te cilit i pandehuri A.B u shpall fajtor për veprën penale “mbrojta ne pronësi, kontroll, posedim ose ne shfrytëzim te paautorizuar te armeve” nga neni 328 par. 2 te KPPK-se, i pandehuri M.K u shpall fajtor për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” nga neni 332 par. 3 te KPPK-se, ndërsa u liruan nga akuza te pandehurit A.B dhe F.M për veprën penale “Shantazhi”, nga neni 268 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, si dhe u lirua nga akuza i pandehuri A.B sa i përket veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve te rrezikshëm dhe substancave psiko-trope” nga neni 229 par. 4 pika

1 te KPPK-se. Aktgjykimi i Gjykatës se Qarkut te Prishtinës është ankimuar nga Prokuroria Publike e Qarkut te Prishtinës me date 14 shkurt 2005 drejtuar Gjykatës Supreme te Kosovës e cila me date 27.12.2005 mori aktgjykimin me te cilin pjesën gjykuese te Gjykatës se Qarkut ne Prishtine e vërtetoj, ndërsa pjesën lirues i ktheu gjykatës se Qarkut te Prishtinës ne Rigjykim. Pas kthimit te çështjes ne rigjykim lënda mori numër te ri dhe pastaj i kaloi ne shqyrtim Gjykatës Themelore ne Prishtine – Departamentit për Krime te Renda. Departamenti për Krime te Renda i Gjykatës Themelore ne Prishtine pas analizimit dhe vlerësimit te shkresave te lendes, me date 16.05.2019 konstatoj se lënda do ti dërgohet Departamentin te Përgjithshëm te kësaj Gjykate pasi qe veprat për te cilat te pandehurit akuzohen janë te dënueshme deri ne dhjetë (10) vite, ashtu qe janë ne kompetence lëndore të Gjykatës Themelore.

Kompetenca e gjykatës:

Sa i përket kompetencës territoriale gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i KPPRK-së, kompetencë territoriale për tu gjykuar një çështje juridiko-penale, ka gjykata në territorin e së cilës është kryer apo është tentuar të kryhet vepra penale, apo në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja. Në rastin konkret vepra penale kishte për të u kryer në rrugën “Fehmi Agani” në Prishtinë, andaj Gjykata Themelore ne Prishtinë është kompetente për të gjykuar këtë çështje juridiko-penale.

Duke vlerësuar kompetencën lëndore, gjykata konstaton se me qenë se vepra penale “Shantazhi”, nga neni 268 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 23 të KPPK-së, parashihet denim me burgim deri në dhjetë (10) vite dhe vepra penale “Blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psiko-tropike” nga neni 229 par. 1 të KPPK-së, parashihet denim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet, andaj gjykata konstaton se, departamenti i përgjithshëm ka kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje.

Shqyrtimi gjyqësor:

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të aktakuzës dhe rrjedhës se gjykimit nga Gjykata e Qarkut ne Prishtinë, aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtine me numër P.nr.448/2004 të datës 22.12.2004, ankesën nga Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë drejtuar ndaj Gjykatës Supreme e dates 14.02.2004, Aktgjykimi i Gjykates Supreme të Kosovës i datës 27.12.2005, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datë: 19.01.2024, ku gjatë kësaj seance kanë qenë prezent prokurorja e shtetit Rukije Sheshivari, i akuzuari F.M me mbrojtësin e tij avokat Alban Makolli, i akuzuari A.B me mbrojtësin e tij avokat Haxhi Derguti, si dhe pala e dëmtuar B.K, ku te akuzuarit pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores së Shtetit, në pyetje të gjykatës, se i pandehuri A.B a e ka kuptuar aktakuzën dhe a ka nevojë për sqarime shtesë, i pandehuri A.B deklaroi se për këtë çështje mbrohet ne heshtje, ndërsa në pyetje të gjykatës ndaj te pandehurit F.M se i njëjti a e ka kuptuar aktakuzën dhe a ka nevojë për sqarime shtesë, i pandehuri deklaroi se: *“dua te deklarohem dhe nuk e pranoj fajësinë ndihem i pafajshëm”*. Në këtë seance janë dhënë fjalët hyrëse nga palët në procedurë, është filluar me administrimin e provave dhe është dëgjuar i dëmtuari - dëshmitari B.K. E propozuar te dëgjohej ka qene edhe dëshmitarja S.K mirëpo pasi janë shtjerr te gjitha mjetet qe sigurojnë pranin e saj ne procedure gjykata ka vazhduar me leximin e deklaratës se saj te dhënë gjate hetimeve. Ne seancën e njëjtë gjykata vazhdoi me dëgjimin e

te pandehurit F.M, ndërsa nuk u dëgjua i pandehuri A.M pasi që i njëjti është deklaruar se mbrohet ne heshtje. Ndërsa në seancën e datës 31.01.2024 ne orën 09:00 palet i kanë dorëzuar me shkrim fjalët e tyre përfundimtare.

Administrimi i provave:

Në mënyrë që të vërtetohet drejt gjendja faktike, gjykata ka bërë edhe administrimin e provave personale dhe atyre materiale, si provat personale: dëshmia e te pandehurit F.M, dëshmia e të dëmtuarit B.K, deklarata e dëshmitares S.K, si dhe provat materiale: raporti i shpejt i policisë i datës 01.07.2004, raporti fillestar i incidentit i datës 02.07.2004, procesverbali mbi kontrollën e personit dhe banesës i datës 05.07.2004, te gjitha këto prova gjenden në shkresat e lëndës. Pasi që i pandehuri M.K e ka pranuar veprën penale për te cilën akuzohet dhe ka marr aktgjykimin e vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, lënda ndaj tij është veçuar dhe te gjitha provat relevante me çështjen e te njëjtit nuk janë administruar. Po ashtu provat për veprën penale “mbajtja ne pronësi, ne kontrole, ne posedim, ose ne shfrytëzim te paautorizuar te armeve” nga neni 238 par.2 te KPPK-se për te cilën i pandehuri A,B është gjykuar, gjykim ky i vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës te gjitha provat relevante me çështjen e kësaj vepre penale nuk janë administruar.

Administrimi i provave personale:

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka vazhduar me procedimin e provave ku gjate shqyrtimit gjyqësor të datës 19.01.2024, ka marr deklaratën e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit, B.K, i cili ne fjalën hyrëse ka deklaruar se nuk qëndron prapa ndjekjes penale te prokurorisë, nuk parashton kërkesë pasuroro-juridike sepse nuk e ndjen veten te dëmtuar, ne cilësinë e dëshmitarit – i dëmtuari B.K deklaroj se te njëjtit nuk i kujtohet saktësisht se çfarë ka deklaruar ne polici dhe prokurori gjate vitit 2004 sepse ka kaluar një kohe e gjate mirëpo i njëjti edhe ne shqyrtimin gjyqësor te mbajtur ne Gjykatën e Qarkut te Prishtinës deklaroj se nuk ka qëndruar prapa ndjekjes penale për arsye se siç tha ai: *“s’kanë qene te vërteta ato që me herët kam deklaro”* dhe *“kemi qene te papjekur sepse dot nuk e kisha bere atë pune unë se bashku me te pandehurin A”*.

I dëmtuari ne cilësinë e dëshmitarit deklaroj: *“atë dite unë si i ri e kam pas marr një kerr dhe ma vjedhjen kerrin ku atë kerr e kisha ble me borxh, edhe tash pak budallakina ime pak e A unë vet thash të thërrasim motrën time që te nxjerr nja pare prej babës se un isha edhe pa kerr edhe pa pare. Për mi than motrës time duhet mi pru paret ku s’po me kujtohet shuma 5000 euro se Bekimi nuk mundet me dal pa i pru paret a na ne fakt ishim ne banës duke pire kafe, s’jam kanë i kërcnum nga askush, atëherë motra e di që ka nga, ka bo diçka, a ka qene ne polici a çka nuk me kujtohet por me sa e di nuk kanë pru por ne atë kohe mentaliteti ka qen ma ndryshe jemi tut prej babës ma shumë se Prokurorisë dhe nuk e kom dit çfarë procedure duhet me kalua neper Gjykata e Prokurori, aj ka qene pak i rreptë dhe kam qene ne gjendje gjithçka me bo veç mos me ra te baba që aj me marr vesh”* Sa i përket lidhjes se te pandehurit F.M me kryerjen e veprës penale për te cilën akuzohet i dëmtuari ne cilësinë e dëshmitarit B.K deklaroj: *“F nuk ka dit asgjë se unë e A s’kemi pas as pare për kafe atë kohe por vetëm ia kemi shfrytëzua kerrin dhe e kemi keqpërdor se aj s’ka dit kurr gjë se na s’kishim kerr mu ën e ky na enke me krye pune”*.

Administrimi i provave materiale:

Gjykata po ashtu ka bere administrimin e provave tjera si: Deklaratën e dëshmitares S.K e dhënë në Polici/UNMIK me datë 07.02.2004 dhe Prokurori me datë 16.07.2007, Deklaratën e të pandehurit A.B e dhënë në Prokurori me datë 15.07.2004, Deklaratën e të pandehurit F.M e dhënë në Prokurori me datë 19.07.2004, Deklaratën e dëmtuarit/dëshmitarit B.K e dhënë në Prokurori me datë 20.07.2004, Deklaratën e dëshmitarit J.K e dhënë në Prokurori me datë 22.07.2004, procesverbali mbi kontrollën e personit dhe banesës i datës 05.07.2004, Raporti i Ekspertizës - Forenzike nga Instituti Hulumtues i Krim Teknikes nga Bullgaria i datës 26.08.2004, foto dokumentacioni prej gjashte (6) fotosh nga qeset e gjetura te narkotikeve gjate kontrollit te banesës si dhe shkresat e tjera qe gjinden ne lende.

Deklarimi i të pandehurit:

Gjykata po ashtu ka marrë edhe deklarimin e të pandehurit F.M i cili deklaroi qe qëndron prapa deklaratës se dhënë ne prokurori dhe gjykatën e Qarkut te Prishtinës, i pandehuri F.M deklaroi se ne ditën kritike A e ka marr ne Ulpianë dhe kanë shkuar ne Bregun e Diellit ku atje e kanë marr te dëmtuarin B.K n dhe i ka lënë te dytë tek Restorant “D----”, nuk e ka pare askënd tjetër aty pastaj ka vazhduar vetëm tek restorant “K-----”. Me tej deklaroi se nuk i ka njohur te dëmtuarin dhe motrën e tij S.K, ku B e ka njohur vetëm si figurë sepse nuk ka folur me te. Pastaj ma vone ne restorantin “K---” ku i pandehuri ishte ulur aty kanë ardhur i pandehuri A.B dhe i dëmtuari B.K mirëpo nuk e ka parë motrën e te dëmtuarit S vetëm ka dëgjuar mirëpo nuk ka qene prezent qe e njëjta ua ka dhënë atyre 1000 euro. Mbrojtësi i te pandehurit A.B av. Haxhi Dërguti pyeti te pandehurin se a i kujtohet a është biseduar diçka rreth borxhit ne shoqëri kur kane qene se bashku, qe i dëmtuari - B i ka borxh A, i pandehuri F.M përgjigjet: “Jo vetëm nga A por edhe nga dëshmitar te tjerë, qe B i ka A borxh, herë u përmendshin 5000 herë 6000 euro”

Fjalët përfundimtare të palëve:

Prokurori i shtetit fjalën përfundimtare e ka sjellë në formë të shkruar si dhe e ka elaboruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës: 31.01.2024 e cila ndër të tjera ka theksuar se: “*Vepra penale për te cilat akuzohen te pandehurit ishte vepër penale te drejtuar kundër pasurisë përkatësisht manifestohet me përdorimin e kanosjes për zbulimin e ndonjë gjëje lidhur me te dëmtuarin apo familjen e tij, e krejt kjo me qellim qe kryesi te përfitojë dobi pasurore te kundërligjshme apo ta detyroj te dëmtuarin qe te merr apo mos merr ndonjë veprim ne dem te vullnetit te tij, te cilin veprim i dëmtuari ne kushte dhe rrethana normale nuk do te bënte. Nga përshkrimi faktik i dispozitivit te aktakuzës ne mënyre te qarte përshkruhen veprimet e te pandehurve si dhe qëllimi i këtyre veprimeve e qe rezulton te jete përfitimi i kundërligjshëm i dobisë pasurore përmes kanosjes dhe detyrimit te të dëmtuarit qe te veprojnë ne dem te pasurisë se tij. Ne këtë shqyrtim gjyqësor ishte fakt se i dëmtuari ne cilësi te dëshmitarit ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim duke shtuar se veprimet përkatësisht paraqitja e rastit ne Polici nga ana e tij ne atë kohe ka qene „budallaki” e tij, por Prokuroria gjen se ne rastin konkret për shkak te mos gjykimit ne kohe te arsyeshme i dëmtuari tani me tendence tërhiqet nga dëshmia e tij për ka Gjykatës i propozojmë qe mos t'ia fal besimin dëshmisë se tij dhënë ne shqyrtim gjyqësor sepse ishte ne kundërthënie me provat e tjera por edhe me vet deklarate e tij te dhënë ne fazat e mëhershme te kësaj procedure dhe se deklarimi i fundit ka gjasë reale te jete i ndikuar nga rrethanat e kohëzgjatjes se këtij gjykimi. Ekzistimi dhe*

kryerja e kësaj vere nga te pandehurit vërtetohet nga dëshmia e te dëmtuarit ne cilësi te dëshmitarit e dhënë ne Prokurori ku i njëjti ne mënyrë te qarte dhe te plote ka përshkruar te gjitha veprimet e te pandehurve te cilin fakt e ka vërtetuar edhe dëshmitarja S.K motra e te dëmtuarit e cila po ashtu ne Prokurori ka përshkruar se është kontaktuar nga te pandehurit te cilët i kane dhënë ne telefon vëllain e saj për ta konfirmuar se ajo duhet t'ua sjell parat veprim te cilin edhe e ka bere madje duke përshkruar (mënyrën se si i ka siguruar mjetet atë natë dhe se si te njëjtat me kërkesë te A i ka dërguar aty ku ai e ka lënë takimin), dhe ka potencuar se gjatë kësaj kohe i pandehuri A ka qene ne shoqëri me te pandehurin F.M Po ashtu edhe nga mbrojtja e te pandehurve e cila mbrojtja ka kundërthënie mes vete por edhe me mbrojtjet e tyre te mëhershme pasi qe i pandehuri F ne mbrojtjen e tij ne shqyrtimin gjyqësor te datës 19.1.2024 ka potencuar mes tjerash se „...kinse A i ka pas borxh këtij, pastaj se ka shkuar me A dhe B deri tek qafa por kur e ka vërejtur se nuk i ka parat është larguar" mirëpo dëshmitarja S ne mënyre bindëse dhe te qarte ka përshkruar se kur ka shkuar tek gafa me kërkesë te A për i dërguar parat dhe ta merr vëllain e saj B, aty ka biseduar me A e qe prezent ka qene edhe i pandehuri F, Mbrojtja e te pandehurit ne shqyrtim gjyqësor ka propozuar qe te administrohen si prova një Padi me te cilën F.M ne cilësi te paditësit kishte paditur këtu te pandehurin A për kinse je borxh por Gjykatës i propozojmë qe mos t'ua fal besimin sepse po qe se shikohet padi rezulton se e njëjta ishte parashtruar me datën 13.10.2004 ndërsa ngjarja kritike ka ndodhur me datën 01.7.2004 me ka vërehet qarte se padia e propozuar si prove ka tendence vetëm shmangien nga përgjegjësia penale. Se ngjarja ka ndodhur ne banesën ne rrugën „Fehmi Agani ne Prishtine" kjo vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit J.K i cili si pronar i njësisë banesore ka deklaruar se banesën ne fale ia kishte dhënë me qira A.K dhe atë qe nga data 15.Maj.2004. Kjo gjendje faktike ishte vërtetuar edhe nga provat e tjera te propozuara dhe administruar përkatësisht nga raporti i oficerit Funsho Farunkule CP#12363 i cili ne raportin e tij përshkruan ngjarjen e hetuar e cila ka ndodhur brenda banesës ne kompleksin e banesave te aeroportit, pastaj përshkruan mjetet (armët) e përdorura te cilat arme janë gjetur dhe sekuestruar me rastin e zbatimit te urdhër kontrollit. Ashtu qe, Gjykatës i propozojmë qe te pandehurit ti gjej penalisht përgjegjës për veprën penale „Shantazhi" nga neni 268 par.2 lidhur me par 1 dhe neni 23 te ish-KPPK, te njëjtit te shpallen fajtor dhe t'u shqiptohet dënim ne baze te ligjit duke i obliguar edhe ne përmbushjen e shpenzimeve te procedurës penale.”

Mbrojtësi i të akuzuarit A.B, avokati Haxhi Dërguti fjalën e tij përfundimtare e ka sjellë në forme të shkruar, si dhe e ka elaboruar në seancën e datës: 31.01.2024, ndër të tjera ka theksuar se: “Ne shqyrtimet kryesore pas administrimit te provave e posaçërisht pas dëgjimit te të dëmtuarit u vërtetuan fakte te pa kontestueshme se i mbrojturi im nuk e ka kryer verën penale te shantazhit për te cilën akuzohet dhe siç është përshkruar ne aktakuze Faktet e vërtetuar gatë shqyrtimeve gjyqësore si vijon: Nga dëshmia e te dëmtuarit rezulton se nuk ekziston asnjë fakt ashtu siç është prezantuar ne aktakuze, e i cili ne shqyrtimin kryesor ka deklaruar nen betim se: "Nuk janë te vërteta ato qe kam deklaruar me herët vetëm janë te vërteta ato qe kam deklaruar ne dëshminë time ne Gjykatën e Qarkut ne Prishtine me date 09.11.2004. Se është vërtetë se unë e kam sajuar rastin për te marr pare nga familja ime se e kam pasur një kerr dhe ma kane vjedhur, ku at kerr e kisha me borxh, unë i thash A te thërrasim motrën time qe ta nxjerr naj pare prej babës se unë isha edhe pa kerr dhe pa pare, me i thane motrës time mi pru 5.000,00 euro, së B nuk mundet me dal pa i pru paret, a ne fakt ishim ne banese tu pi kafe, dhe nuk jam kanë i kërcnum nga

askush. Pastaj motra a ka be nuk di ,de ma shume nuk me kujtohet, nuk e kam dit se duhet me kalu neper gjykata e prokurori". Pastaj i dëmtuari ne shqyrtimin kryesor ka deklaruar se mbetet ne tërësi ne dëshminë e dhënë me datën 09.11.2004 ne faqen 2 dhe 3 te procesverbalit te gjykatës se çarkut ku ka deklaruar nën betim se "Se është e vërtete se unë A.B i kam pasur borxh shumen prej 6.000,00 Euro, ato te holla A mi ka kërkuar se gjoja ja kishte borxh F.M, shton se nuk është e vërtetë se dikush ju ka kërcënuar me revole apo pushkë automatike, po ashtu nuk është e vërtetë se A mi ka kërkuar 14,000 apo 10.000 Euro, duke deklaruar se vërtet është ajo qe po thotë sot ne gjykatë ,se deklaratat e me hershme i kam dhanë me presion te Policisë" Me tej ka deklaruar "se ditën kritike kur ka ardh A e kam dite se aj ka ardh me bisedu për borxhin te cilin ja kam pas" Nga dëshmia e te dëmtuarit rezulton se ne veprimet e te mbrojturit tim nuk janë plotësuar asnjë nga elementet e veprës penale te shantazhit. Sipas përshkrimit ligjor te veprës penale te shantazhit neni 268 shprehimisht theksohet: " 1. Kushdo qe me qellim për ti sjell vetes apo tjetrit dobi pasurore te kundërligjshme i kanoset personit tjetër se kundër tij apo personave te tij te afërt do ti zbuloj diç qe do ta dëmtoj nderin apo autoritetin e tyre dhe me këtë e detyron atë person të veproj ose te mos veprojë ne dem te pasurisë se tij a pasurisë se ndonjë personi tjetër dënohet me burgim prej 3 muajve deri ne pese vite" "2. Nëse vera penale nga par. 1 i këtij neni është kryer nga kryesi i cili vepron si anëtarë i grupit duke përdorur ndonjë arme ose mjet te rrezikshëm apo rezulton me dobi të madhe pasurore, kryesi dënohet me burgim prej një deri ne dhjetë vjet." Ky përshkrim ligjor i veprës penale te shantazhit nuk përputhet me gjendjen faktike te vërtetuar ne shqyrtimin kryesor sepse nga dëshmia e te dëmtuarit asnjë nga këto elemente te veprës penale nuk janë përmbushur. Nga provat ne shkresat e lendes nuk rezulton qe i akuzuari A ti këtë thënë te dëmtuarit se do zbuloj diçka për te apo te afërmit e tij, por vetëm i ka kërkuar borxhin qe ja kishte e te cilin rast e kishte sajuar vete i dëmtuari me qellim qe te përfitoj nga familja e tij dobi pasurore e jo tani i akuzuari A i cili i ka marre vetëm 1000 euro ne emër te borxhit qe ja kishte i dëmtuari nga shuma prej 6.000 euro. Po ashtu ne par.2 te këtij neni theksohet se nëse vera penale është kryer si anëtarë i grupit duke përdorë armen ose mjet te rrezikshëm me dobi te madhe pasurore kryesi dënohet nga një vit deri ne dhjete vite. Edhe ne këtë rast nuk kemi te bëjmë me elementin e grupit as me dobi te madhe pasurore as përdorimin e armëve apo mjetin tjetër te rrezikshëm, sepse i dëmtuari dy here para gjykatës ka deklaruar se ndaj tij nuk është përdorë asnjë lloj kërcënimi apo ka vërejtur se i akuzuari A apo personi tjetër te kenë pasur arme. Nga te cekurat me larte nuk ekziston asnjë element i veprës penale te shantazhit sepse elementi i pare i kësaj vepre është: -te zbuloj diçka qe mund te dëmtoj nderin ose autoritetin duke detyruar qe te veproj ose mos veproj ne dëme te pasurisë se tij me qellim te përfitimit te kundërligjshëm -Faktet mund te jene rrethana nga jeta personale dhe familjare, raportet me njerëzit tjerë, veprimtari profesionale a rrethana tjera zbulimi i te cilave te dëmtuarit apo te afërmeve te tij mund te done nderin apo autoritetin. Nga këto elemente te veprës penale te shantazhit nuk ekziston asnjë prove qe do te dëshmonte ndonjë veprim te te akuzuarit Ne shkresat e lendes dhe ne shqyrtimet kryesore as qe përmenden këto elemente qe i akuzuari ti këtë përdorë gatë kontaktit me te dëmtuarin as me komunikimin me dëshmitaren S.K. Lidhur me këtë nuk ekziston as elementi subjektiv ai i dashjes direkte, që ka qëllimin përfitimin e dobisë pasurore te kundërligjshme. Andaj asnjë nga këto elemente te veprës penale nuk ekzistojnë dhe as qe janë vërtetuar ne shqyrtimet kryesore dhe as provat qe vërtetojnë veprimin e kundërligjshëm. Andaj nga te cekurat me larte ne mungese te provave i akuzuari A.B te lirohet nga akuza ashtu siç ka vepruar edhe gjykata e çarkut ne Prishtine me aktgjykimin 448/2004 te datës 22.12.2004. II.

Aplikimi i ligjit me te favorshëm Gjykatës i propozoj qe te shqyrtoj një fakt te rëndësishëm qe shkon ne favor te këtij procesi penal e qe ka te bej me aplikimin e ligjit me te favorshëm nga neni 3 par. 2 i kodit penal te Kosovës, ku theksohet se "N' rast se ligji ne fugi ndryshon para shqiptimit te vendimit te formës se prere, atëherë ndaj kryerësit zbatohet ligi qe është me i favorshëm. gjykata ka obligim qe te aplikoj ligjin me te favorshëm ne rastin konkret sepse para 2 i nenit 268 i vitit 2004 ne kohen kur është kryer vera penale përcakton dobi te madhe pasurore pa e përcaktuar vlerën e dobisë pasurore, ndërsa kodi penal ne fuqi, vepra penale e shantazhit neni 329 par.2 përcakton se nëse vera penale e shantazhit rezulton me dobi pasurore te kundërligjshme ne shumen qe tejkalon 10.000,00 Euro kryesi dënohet prej 1 deri ne 10 vjet. Andaj i propozoi gjykatës qe me rastin e vendosjes te kite parasysh te aplikimin e ligjit me te favorshëm qe ne rastin konkret te ri kualifikoj veprën penale me paragrafin 1 e jo me paragrafin 2 te kodit penal si ligj me i favorshëm."

Mbrojtësi i të akuzuarit F.M avokati Alban Makolli fjalën e tij përfundimtare e ka sjellë në forme të shkruar, si dhe e ka elaboruar në seancën e datës: 31.01.2024, ndër të tjera ka theksuar se: *"Ne Rigjykim, pas administrimit te provave, ne veçanti deklarimit te vet te dëmtuarit B.K si prova e vetme dhe vendimtare, si dhe duke mos pasur asnjë prove tjetër relevante dhe inkriminuese, me te cilën se paku krijohej dyshimi se këtu i pandehuri F.M i bashkëpandehuri A.B si dhe ndonjë person i trete, përfshirë personin e ashtuquajtur si A, se paku te kenë poseduar arme me rastin e dyshimit te ndërmarrjes se veprimeve inkriminuese, ku lidhur me te vërtetuarit e këtij fakti, vet i dëmtuari shprehimisht ne seancën e datës 19.01.2023, ne pyetjet e parashtruara se: "A ka qene ne prezencën tuaj F.M me revole ne dore, si dhe personi me emrin A me pushke automatik AK47?, i njëjti u përgjigj se "JO". Andaj, nga dhënia e kësaj përgjigje, rezulton se nuk është vërtetuar elementi i "përdorimit te armës", dhe i te "vepruarit ne grup", si njeri nga elementet qe e sajojnë tërësinë e elementeve objektive dhe subjektive te veprës penale "Shantazhi" nga neni 268 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 te Kodit te Përkohshëm Penal, siç e përcakton e njëjta se: "Nëse vera penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer nga kryerësi i cili veron si anëtare i grupit duke përdorur ndonjë arme ose mjet te rrezikshëm apo rezulton me dobi të madhe pasurore, kryerësi dënohet me burgim prej nj deri ne dhjet vjet, prandaj ne mungesë te vërtetimit këtij elementi qe i jep formën e rënde kësaj vere penale dhe e kualifikon sipas paragrafit 2, rezulton se Gjykata duhet te përkujdeset sipas detyrës zyrtare dhe ne baze te nenit 359 par.2 te KPPRK-së, i cili përcakton se: "2. Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit te shtetit lidhur me kualifikimin ligjor te veprës.", te bej rikualifikimin e veprës penale nga paragrafi 2, ne paragrafin 1 te nenit 268 te KPK-se, dhe meqë sipas formës baze, ndëshkues mëria e kësaj vepre penale është maksimum 5 vjet, rezulton se për ndjekjen penale te se njëjtës ka arritur afati i parashkrimit ne baze te nenit 90 par. 1, pika 4 lidhur me nenin 91 par.6 te KPK-se. Pas rikualifikimit si me sipër, meqë ka arritur afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale, kërkojmë nga Gjykata qe ne baze te nenit 362, par. 1 pika 1.3 te KPPRK-së të sjelle Aktgjykim Refuzues për shkak te rrethanave qe përjashtojnë ndjekjen penale. 2) Çështja e rikualifikimit është ngritur edhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Supreme te Kosovës AP.nr.206/05, te marre me date 27.12.2005, ne te cilin nder te tjera është dhënë udhëzimi qe te shqyrtohet kualifikimi juridik, dhe kjo me te drejte ngase ne rastin konkret kemi pasur 2 te akuzuar dhe vetëm 2 te dyshuar për ndërmarrjen e veprimeve inkriminuese, kurse dispozita juridike e nenit 268 par.2 e parashih qe vepra duhet te kryhet si "anëtare i grupit", e qe grup konsiderohet pjesëmarrja e se*

paku 3 personave, e qe binte ndesh haptazi me aktakuzën e ushtruar. Kësisoj me te drejte edhe Gjykata e instancës me te larte nder udhëzime te tjera, kishte dhënë edhe çështjen e kualifikimit. II. Kërkesa për marrjen e aktgjykimit lirues ne baze te nenit 364 par.1 pika 1 te KPPRK- se: 3) Hipotetikusht, nëse Gjykata nuk sjelle Aktgjykim refuzues, nga e njëjta kërkojmë qe ne mungese te provave, te sjelle aktgjykim lirues, ngase: nga provat e administruara, me asnjërin prej tyre nuk u vërtetua qe i mbrojturi im te këtë kryer veprimet inkriminuese sikurse ne aktakuze. Prova e vetme dhe vendimtare ne këtë çështje, e qe është vet i deklarimi i te dëmtuarit B.K, njëkohësisht edhe dëshmitar okular, qarte e ka sqaruar se i pandehuri F.M nuk ka ndërmarrë asnjë veprim inkriminues ndaj tij, dhe se ka qene ai me te bashkëpandehurin A.B te cilët kane vene ne lajthitje dhe e kanë mashtruar motrën e te dëmtuarit B.K, S.K, kurse i pandehuri F.M fare nuk ka qenë ne dijeni për asnjërin veprim te ndërmarrë nga i dëmtuari B.K dhe i bashkëpandehuri A B. Vet i dëmtuari në asnjë pjese të deklaratës se tij nuk e ka deklaruar asnjë fakt inkriminues te ndërmarrë nga i mbrojturi im. Deklarata e te dëmtuarit ishte prova vetme, direkte dhe vendimtare ne këtë çështje, ngase vetëm ai kishte qenë prezent gatë momentit kur dyshohet se janë ndërmarrë verimet inkriminuese sikurse ne aktakuze, dhe asnjë dëshmitar tjetër, dhe si dëshmitar i vetëm qe ka mundur te vërtetoj fakte inkriminuese apo shfajësuese, i njëjti bindshëm ka deklaruar i mbrojturi im nuk ka ndërmarrë asnjë veprim inkriminues, dhe kësisoj e ka vërtetuar pafajësinë e te mbrojturit tim se nuk është kryes i verës penale sikurse ne aktakuze. 4) Përveç deklaratës se te dëmtuarit, nuk kishte asnjë prove tjetër që e vërtetonte se i pandehuri F.M te këtë ndërmarrë ndonjë veprim ne drejtim te te dëmtuarit B.K, aq me pak qe ta shantazhonte, kërcënonte, frikësonte apo te kërkonte ndonjë para nga i njëjti. Kësaj vere penale është maksimum 5 vjet, rezulton se për ndjekjen penale te se njëjtës ka arritur afati i parashkrimit ne baze te nenit 90 par. 1, pika 4 lidhur me nenin 91 par.6 te KPK-se. Pas rikualifikimit si me sipër, meqë ka arritur afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale, kërkojmë nga Gjykata qe ne baze te nenit 362, par. 1 pika 1.3 te KPPRK-së të sjelle Aktgjykim Refuzues për shkak te rrethanave qe përjashtojnë ndjekjen penale. 2) Çështja e rikualifikimit është ngritur edhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Supreme te Kosovës AP.nr.206/05, te marre me date 27.12.2005, ne te cilin nder te tjera është dhënë udhëzimi qe te shqyrtohet kualifikimi juridik, dhe kjo me te drejte ngase ne rastin konkret kemi pasur 2 te akuzuar dhe vetëm 2 te dyshuar për ndërmarrjen e veprimeve inkriminuese, kurse dispozita juridike e nenit 268 par.2 e parasheh që vepra duhet te kryhet si "anëtare i grupit", e qe grup konsiderohet pjesëmarrja e se paku 3 personave, e qe binte ndesh haptazi me aktakuzën e ushtruar. Kësisoj me te drejte edhe Gjykata e instancës me te larte nder udhëzime te tjera, kishte dhënë edhe çështjen e kualifikimit. II. Kërkesa për marrjen e aktgjykimit lirues ne baze te nenit 364 par.1 pika 1 te KPPRK- se: 3) Hipotetikusht, nëse Gjykata nuk sjelle Aktgjykim refuzues, nga e njëjta kërkojmë qe ne mungese te provave, te sjelle aktgjykim lirues, ngase: nga provat e administruara, me asnjërin prej tyre nuk u vërtetua qe i mbrojturi im te këtë kryer veprimet inkriminues sikurse ne aktakuze. Prova e vetme dhe vendimtare ne këtë çështje, e qe është vet i deklarimi i te dëmtuarit B.K, njëkohësisht edhe dëshmitar okular, qarte e ka sqaruar se i pandehuri F.M nuk ka ndërmarrë asnjë veprim inkriminues ndaj tij, dhe se ka qenë ai me te bashkëpandehurin A.B te cilët kane vene ne lajthitje dhe e kanë mashtruar motrën e te dëmtuarit B.K, S.K, kurse i pandehuri F.M fare nuk ka qenë ne dijeni për asnjërin veprim te ndërmarrë nga i dëmtuari B.K dhe i bashkëpandehuri Agron Bajrami. Vet i dëmtuari në asnjë pjese të deklaratës se tij nuk e ka deklaruar asnjë fakt inkriminues te ndërmarrë nga i mbrojturi im. Deklarata e te dëmtuarit ishte prova vetme, direkte

dhe vendimtare ne këtë çështje, ngase vetëm ai kishte qenë prezent gatë momentit kur dyshohet se janë ndërmarrë verimet inkriminuese sikurse ne aktakuze, dhe asnjë dëshmitar tjetër, dhe si dëshmitar i vetëm qe ka mundur te vërtetoj fakte inkriminuese apo shfajësuese, i njëjti bindshëm ka deklaruar i mbrojturi im nuk ka ndërmarrë asnjë veprim inkriminues, dhe kësisoj e ka vërtetuar pafajësinë e te mbrojturit tim se nuk është kryes i verës penale sikurse ne aktakuze. 4) Përveç deklaratës se te dëmtuarit, nuk kishte asnjë prove tjetër qe e vërtetonte se i pandehuri F.M te këtë ndërmarrë ndonjë veprim ne drejtim te të dëmtuarit B.K, aq me pak qe ta shantazhonte, kërcënonte, frikësonte apo te kërkonte ndonjë para nga i njëjti.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me vendosjen:

Gjykata duke vlerësuar të gjitha provat, në përputhje me nenin 361, 362 dhe 363 të KPPK-së, si deklaratata e të dëmtuarit ne cilësi te dëshmitarit B.K, deklaratata e të akuzuarit F.M vërtetohet gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata pas shikimit të shkresave të lëndës konstatoj se vepra si në pikën II të dispozitivit është parashkruar. Pasi që në bazë të nenit 106 par. 1, pika 1.6, të KPRK-së, parashihet se parashkrimi shkaktohet në afat prej 2 vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në 1 (një) vit burgim. Në bazë të nenit 107, par. 8 të KPRK-së, ndjekja penale ndalohe në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, respektivisht ndalesa absolute mbi ndjekjen penale e që në rastin konkret parashkrimi për veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja, dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psiko-tropike” nga neni 229 par. 1 të KPPK-së dënimi është me gjobë dhe me burgim prej një deri në pesë vjet ka arritur me datë me datën 05.07.2014.

Elementet e veprës penale “Shantazhi” nga neni 268 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPPK-së lidhur me nenin 23 të KPPK-së: “Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, kanos personin tjetër se do të zbulojë diç në lidhje me të apo personat e afërm të tij që do të dëmtojë nderin apo autoritetin e tyre dhe në këtë mënyrë e detyron personin e tillë të kryej apo të mos kryejë ndonjë veprim në dëm të pasurisë së tij apo të personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit apo kryhet me përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm ose vepra penale rezulton me dobi pasurore të kundërligjshme në shumën që tejkalon dhjetëmijë (10.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

Andaj veprimi i kryerjes është kanos personin tjetër se do të zbulojë diç në lidhje me të apo personat e afërm të tij që do të dëmtojë nderin apo autoritetin e tyre. Pas administrimit të gjitha provave gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, gjyqtari i çështjes vërtetoj këtë gjendje faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, në bazë të dëshmimeve të te dëmtuarit gjate shqyrtimit gjyqësor ne Gjykatën e Qarku te Prishtinës, dhe provave materiale, duke nxjerrë përfundime se faktet konkrete janë provuar, lidhur me vendimin e gjykatës që të pandehurit të lirohen nga Aktakuza për veprimet dhe veprën penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata sjellë në vëmendje se, përgjegjësia penale është detyrimi ligjor i çdokujt, që shkel një rregullim normativ me karakter penal, për t'iu nënshtruar pasojave ligjore me karakter ndëshkues e parandalues. Nisur nga rëndësia që kanë, organet proceduese penale përgjatë të gjithë veprimtarisë që përbën në tërësi procedimin penal, nga intensiteti i madh i kufizimit të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve të nënshtruara dhe nga nevoja për zhvillimin e një procedimi të ndershëm, të rregullt dhe tërësisht në përputhje me ligjin, Kodi Penal ka parashikuar disa kushte kumulative që duhet të përmbushen në çdo procedim penal. Legjislacioni duke konkretizuar parimin e ligjshmërisë të shprehur në nenin 2 të KPRK-së, në pjesën e posaçme të Kodit Penal, ka parashikuar edhe llojet e veprave penale dhe llojet apo masat përkatëse të dënimeve për to. Sipas të drejtës sonë penale, e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të caktuar veprave penale, të parashikuar nga ligji penal. Për këtë arsye, bashkë ekzistenca e njëkohshme e elementeve të figurës së veprës penale ka një rëndësi sepse lidhet domosdoshmërisht me zbatimin e parimit të ligjshmërisë.

Gjykata gjithashtu thekson se barra e të provuarit, se i akuzuari është fajtor për veprën penale, i përket prokurorisë ashtu që prokuroria është e obliguar që të vërtetojë me prova, se ekziston përtej dyshimit mirë të bazuar, se te akuzuarit kane kryer veprën penale për të cilën ngarkohen. Në aspektin procedural penal, te akuzuarit mbulohen nga parimi i prezumimit të pafajësisë si dhe parimi *“In Dubio Pro Reo”* (Mëdyshjet lidhur me provat dhe faktet si dhe zbatimin të ligjit zbatohen në favor të të pandehurit), po ashtu te akuzuarit nuk janë te detyruar që ta provoj fajësinë apo pafajësinë e tyre.

Po ashtu, edhe pse dispozita e nenit 325 par.4 të KPPK-së, e parashikon të drejtën e Gjykatës që *“Përveç provave të propozuara nga palët dhe i dëmtuari ose viktima, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues ka të drejtë të sigurojë provën që e konsideron të nevojshme për verifikimin e drejtë dhe të plotë të çështjes penale”*, kjo dispozitë procedurale nuk e kthen gjykatën në palë, për të siguruar prova, në procesin penal, sepse në të kundërtën do të shkelet parimi i paanshmërisë dhe do të zhveshët nga autoriteti që realizon dhënien e drejtësisë dhe do të merr rolin e autoritetit ndjekës, andaj gjykata nuk ka vlerësuar të domosdoshme dhe të nevojshme për të marrë prova shtesë për ndriçimin e gjendjes faktike pasi që ka konsideruar se provat e administruara gjate këtij shqyrtimi gjyqësorë kanë qenë të mjaftueshme për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike.

Që i akuzuari të gjendet fajtor nga gjykata, duhet të provohet se aktakuza e ngritur nga prokuroria është e provuar dhe argumentuar përtej dyshimit të bazuar mirë, e që në rastin konkret prokuroria nuk ka mundë ta bindë gjykatën se me provat e propozuara dhe administruar në shqyrtim gjyqësor te akuzuarit kane kryer veprën penale për të cilën ngarkohen sipas aktakuzës. Prezumimi i pafajësisë dhe barra e të provuarit janë kërkesa imperative dhe të artikuluar në të gjitha të drejtat dhe konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, e të cilat janë inkorporuar në nenin 3 të KPPRK-së (*Prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe Parimi In Dubio Pro Reo*) dhe nenin 7 par.1 të KPPRK-së, që nënkupton detyrimin e përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve, këto konstatime gjejnë mbështetje në nenin 11 të Deklaratës Universale

për të Drejtat e Njeriut, neni 6 par.2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14 par.2 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Andaj, bazuar në detyrimet ligjore e duke vepruar në zbatimin e drejtë dhe të saktë të dispozitave ligjore gjykata me bindje të lirë e në mungesë të provave ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve A.B dhe F.M nuk janë provuar përtej dyshimit mirë të bazuar se te njëjtit kane kryer veprën penale.

Bashkëkryerja

Pohimi i Prokurorisë Themelore të Republikës së Kosovës se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer veprat penale si në aktakuzë ishte vetëm një dyshim i cili nuk ka mbështetje në asnjë provë të besueshme – relevante, pasi që bashkëkryerja ekziston “*kur dy apo më shumë persona duke marr pjesë në veprimin e kryerjes apo në ndonjë mënyrë tjetër së bashku kryejnë vepër penale,*”. Për të ekzistuar kjo formë e bashkëpunimit duhet të plotësohen elementi objektiv, pra si bashkëkryerës është personi i cili së bashku me të tjerët ndërmerr veprimin e kryerjes së veprës penale të caktuar si dhe elementi subjektiv pra si bashkëkryerës është personi i cili së bashku me tjetrin në bazë të marrëveshjes mbi ndarjen e punës realizon pjesën e vet në procesin e kryerjes së veprës penale e ka dëshiruar pasojën dhe veprën penale e konsideron si të veten.

Nuk është kontestues fakti se ditën kritike, pra me datë 01.07.2004, i dëmtuari B.K fton motrën e tij S.K dhe arrijnë një marrëveshje qe te sjell shumen prej 1.000 eurosh, duke u takuar me te pandehurin A.B kjo u vërtetua nga deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit B.K e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nga dëshmia e motrës se te dëmtuarit ne prokurori e datës 16.07.2004 dhe nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Po ashtu i pakontestueshëm është fakti se me datën 01.07.2004 rreth orës 11:30 ne Prishtine te pandehurit A.B dhe F.M kane shkuar ne banesën e B.K ne lagjen e Bregut te Diellit ne Prishtine dhe te njëjtin e kane ftuar për kafe kjo u vërtetua nga deklarata e të dëmtuarit-dëshmitarit B.K e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor nga dëshmia e babait e dhënë me date 22.07.2004 si dhe nga shkresat e lëndës.

Për gjykatën, kontestues ishte fakti se me datë: 01.07.2004 rreth orës 11:30 te pandehurit A.B dhe F.M ne bashkekryerje kane kryer veprën penale “Shantazhi” nga neni 268 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPPK-së lidhur me nenin 23 të KPPK-së, ashtu sikurse që përshkruhet ne aktakuzën me numër PP.II.nr.485/04 të datës 02.08.2004, Gjyqtari i vetem gjykues sipas KPPRK-se, pas fjales hyrese te paleve kishte filluar procedimin me dëgjimin e të dëmtuarit B.K në cilësinë e dëshmitarit ku i njëjti me rastin e pyetjeve të parashtruara nga prokurori i shtetit është përgjigjur se nuk qëndron prapa deklaratës se dhënë ne prokurori me date 20.07.2004, pasi qe sipas te dëmtuarit kishin planifikuar gjithçka se bashku me te pandehurin A.B sepse te dëmtuarit B.K ia kishin vjedhur veturën dhe kishte mbetur pa para andaj kishin bere planin qe te gjenin disa para nga familja e te dëmtuarit dhe i njëjti duke vepruar ne atë mënyrë qe familja e tij te mos marre vesh te vërtetën ka dhënë deklaratën e lartpërmendur ne Prokurori sepse ka qene i frikësuar nga babai i tij dhe nuk e ka ditur se si do te zhvillohet procedura penale dhe ka qene ne gjendje te beje gjithçka vetëm qe babai tij te mos marr vesh te vërtetën mirëpo ne Gjykate

është tërhequr, ne procedure gjyqësore te Gjykatës se Qarkut te Prishtinës ka deklaruar se nuk kane qene te vërteta ato qe me herët ka deklaruar ne prokurori, dhe te njëjtin qëndrim mbajti edhe ne shqyrtimin e Gjykatës Themelore ne Prishtine me date 19.01.2024, i dëmtuari B.K po ashtu deklaroi se i pandehuri F.M nuk ishte ne dijeni me planin e thurur mes tij dhe te pandehurit A.B

Po ashtu gjykata sa i përket kualifikim te veprës penale “Shantazhi” nga neni 268 par 2 “Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni është kryer nga kryerësi i cili vepron si anëtarë i grupit duke përdorur ndonjë armë ose mjet të rrezikshëm...” në pyetjen e gjykatës se ne ditën kritike me date 01.07.2004 i pandehuri F.M ka qene ne prezencën e te dëmtuarit me revole ne dore, i njëjti përgjigjet, jo nuk ka qene, dhe personi i ashtuquajtur personi A me pushkë automatike A47, I dëmtuari përgjigjet jo nuk ka pasur.

Nga kjo del se gjykata me rastin e marrjes së dëshmisë nga ana e të dëmtuarit, në cilësinë e dëshmitarit, gjeti se i dëmtuari nuk qëndron prapa deklaratës se tij nga baza e se cilës deklaratë te pandehurve A.B dhe F.M do te ju vihej barre vepra penale “Shantazhi” nga neni 268 par. 2 lidhur me par. 1. Andaj gjykata ka gjetur se në bazë të kësaj deklaratë nuk është arritur të vërtetohet se te pandehurit A.B dhe F.M e kane kryer veprën penale për të cilën akuzohen për shkak se nga dëshmia nuk është arritur të vërtetohet kjo e aq me shume kur i dëmtuari deklaroi se ajo nuk ka ndodhur dhe asnjëherë nuk është kërcënuar apo kanosur nga te njëjtit.

Tutje gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka vazhduar me marrjen në pyetje të te pandehurit F.M i cili është deklaruar se i pandehuri A.M ne atë kohe kishte një borxh ndaj tij andaj i njëjti nuk ka marre as edhe një veprim ne lidhje me te hollat ndaj te dëmtuarit B.K ngase borxh i kishte i pandehuri A.B te dëmtuarin nuk e njihte me te vërtet vetëm si fytyrë, ndërsa motrën e te pandehurit nuk e kishte pare asnjëherë dhe nuk e njihte. Po ashtu i pandehuri deklaroi se nuk e kishte pare dëshmitaren S por kishte dëgjuar qe e njëjta ia kishte dhënë te pandehurit A.B, 1.000 euro. Gjykata vlerëson se nga deklarata e të njëjtit nuk ka mundur të gjetet se i njëjti ka pasur njohuri për kryerjen e veprës penale e po ashtu faktin se kryes i veprës penale është vete ai dhe i pandehuri A.B.

Nga Raporti fillestar i incidentit me nr. 04-11347 i datës 02.07.2004, rezulton se me datë 02.07.2004 rreth orës 12:00 ne RCS Prishtina është paraqitur rasti Kidnapim – marrje e pengut, kërkesë për te holla për lirim (haraç) e cila kishte ndodhur afër qendrës se stafit te aeroportit ne Prishtine. Nga Raporti 24 orësh me nr. 04/11347 te datës 03.07.2004 nga hetuesi Fusho Farunkule, rezulton se rreth orës 15:30 te datës 02.07.2004 i dëmtuari B.K ka raportua se kishte qene i kidnapuar nga një grup personash ne Prishtine një nate me pare dhe është liruar vetëm pasi motra e tij kishte paguar harraçin, ne raportin 24 orësh janë përshkruar veprimet e ndërmarra nga njësi të përkatës, si dalja në vendin e ngjarjes, deklaratat e dhëna vullnetarisht nga i dëmtuari dhe motra e tij, vëzhgimi i shtëpive te A.B dhe është lokalizuar shtëpia e F,M dhe njoftimi i hetuesisë dhe ekipeve tjera si KFOR për veprimet e mëtutjeshme hetimore.

Të gjitha këto prova materiale janë prova të besueshme dhe të pakontestueshme por paraqesin vetëm anën objektive të kryerjes së veprës penale dhe se këto prova nuk ndriçojnë asnjë aspekt subjektiv të kësaj vepre penale e për më tepër nuk paraqesin ndonjë ndërlidhje të drejtpërdrejtë

apo të tërthortë se kryes janë te akuzuarit, andaj nga kjo arsye Gjykata vlerësoi se nuk është e nevojshme që këto prova t'i trajtoi më tepër.

Faktet që u potencuan më lartë, paraqesin elementet objektive të veprës penale, Shantazhi, për të cilën akuzohen të pandehurit, andaj gjykata në këtë shqyrtim gjyqësor është përqendruar në vërtetimin e elementit subjektiv të veprës penale nga shkakku se enigmatike ka qenë pikërisht ky element i cili nuk është arritur të argumentohet me asnjë provë materiale dhe personale nga se në asnjë mënyrë nuk u vërtetuan elementet e saj, saktësisht se a janë përfshirë vërtetë në veprimet inkriminuese te pandehurit dhe cilat janë ato veprime, ashtu që për të ekzistuar kjo vepër duhet të ekzistoi një lidhje organike në mes të këtyre veprimeve, andaj edhe mbi këtë bazë edhe është përjashtuar përgjegjësia e tyre.

Po ashtu sipas përshkrimit të veprimeve inkriminuese të të akuzuarve në dispozitivin e aktakuzës se te akuzuarit në ditën dhe vendin kritik, *“rreth orës 11:30 minuta në Prishtinë të pandehurit A.B dhe F.M kanë shkuar në banesën e të dëmtuarit B.K, lagja Bregu i diellit në Prishtinë, pasi e kanë ftuar me dal me pi kafe, gjatë rrugës kanë marrë një person me emrin A pastaj shkojnë në kompleksin e banesave të personelit të aeroportit dhe hyjnë në banesën hyrja 7 nr. 56 rruga "Fehmi Agani" në Prishtinë, dhe posa hyri i dëmtuari B.K në banesë, u ulën, i ofrojnë një pije, në ndërkohë F.M i tha A.B se unë po dal jashtë ndërsa do të kthehem më vonë pastaj e ka ftuar An deri te dera, ndërsa i dëmtuari ka mbetur brenda me personin e quajtur A, pastaj A u kthye dhe i tha të dëmtuarit B.K "puna është keq". I dëmtuari pyet se çka ka të re, A Bajrami i tha se F.M po lyp haraq prej teje, ku në fillim A.B ka kërkuar 16.000 euro pastaj ka ra në 14.000, ndërsa pas një ore ka ra në 10.000 euro, ku A.B ia tërhoqi vërejtjen të dëmtuarit se në një farë mënyrë ne jemi të rrethuar nga F me shokë dhe i tha se nëse tenton diçka F M është prapa teje në kuzhinë dhe do të shkon kryet, dhe i njëjti i thotë se F është me revole në dorë, këtu ka qenë prezent edhe personi i quajtur A, i cili e ka marrë pushkën automatike A-47 dhe e ka vendosur në karrige, pastaj kanë urdhëruar të dëmtuarin B.K n që të marr telefonin e tij mobil dhe të thërras babain e tij dhe ti thotë se ka borxh një shumë prej 14.000 dhe se duhet t'i sjell ato para ose do të vritet.”*, janë te gjitha sipas deklaratës se te dëmtuarit B.K te cilën nuk qëndron pas dhe deklaroi që nuk janë te vërteta sepse kane qene te ri dhe kane bere disa “budallakina” ne atë kohe.

Prandaj gjykata ua fali besimin në tërësi deklaratës se dhënë te te dëmtuarin B.K e cila përputhet me deklaratën e dhënë ne Gjykatën e Qarkut ne Prishtine si dhe deklaratës së dhënë nga i akuzuari F.M për faktin se mbrojtja e tij është kuptimplote dhe se i njëjti ka deklaruar në mënyrë të njëjtë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale, dhe se një gjë e tillë argumentohet edhe nga provat tjera që janë proceduar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, siç janë dëshmia e te dëmtuarit B.K si dhe provat materiale. Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor vlerësoi pretendimet e Prokurorisë por e njëjta nuk arriti të argumentoj me fakte dhe prova para gjykatës elementet e veprës penale, Shantazhi nga neni 268 par. 2 lidhur me par. 1 të KPPK-së, si në dispoziv të këtij aktgjykimi, me të cilën vepër ngarkohen te akuzuarit, ngase nga provat e administruara nuk gjeti se në veprimet e të akuzuarve formësohen elementet qenësore subjektive dhe objektive të veprës penale, e që përbëjnë figurën e veprës penale të cekur më lartë për të akuzuarit, për të cilën akuzoheshin, andaj nisur nga të gjitha këto që u thanë gjykata pasi analizoi dhe vlerësoi provat

e administruara dhe fjalët përfundimtare të mbrojtjes se te akuzuarve nuk gjeti se në veprimet e të akuzuarit formësohen elementet e veprës penale të lartcekur dhe në mungesë të provave dhe mos ekzistimit të elementeve të veprës penale, konform nenit 363 par.1 nënëpar.1.3 të KPPRK-së, të akuzuarin për veprën penale si në dispozivit të këtij aktgjykimi e liroi nga akuza.

Pasi qe nuk është kontestuese që i dëmtuari B.K ditën kritike e ka telefonuar motrën e tije S.K, për ti sjellë parat se në Restaruant por i njëjti i dëmtuar tani në gjykatë pohon se e ka bërë nga budallakia ndërsa S.K, nuk u dëgjua sepse në raport me te nuk është kontestues se e njëjta ju ka sjellë 1,000.00 euro dhe se ka përjetuar ankth por a ishte vërtetë B i detyruar ti telefononte apo jo këtë i njëjti pohon në gjykatë se nuk ishte i detyruar ndërsa shtetasi turk i cili mendohet se ka banuar në atë banës nuk u tentua te gjendej sepse për veprën penale narkotik veç kishim parashkrim.

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pakontestueshme, në favor dhe ato jo në favor të te akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPRK-së, parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin “in dubio pro reo”, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Prandaj, në mungesë të provave bindëse dhe të pakontestueshme, gjykata konform nenit 363 paragrafi 1 pika 1.3, liroi nga akuza të akuzuarit A.B dhe F.M sepse nuk është provuar se te njëjtit kane kryer veprën e cila u vihet në barrë sipas aktakuzës.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 par.1 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 363, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2019:088056, 08.03.2024

Bashkëpunëtori Profesional:
Asdren Selmani

Gjyqtari:
Sabit Sadikaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykatë për Gjykatën e Apelit Prishtinë.